



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E FINANCAVE/MINISTARSTVO ZA FINANSIJE
MINISTRY OF FINANCE

KB FR Kosovo Board on Standards for Financial Reporting
 BK RF Bordin Kosovari mbi Standardet për Raportim Financiar
 KB FI Kosovski Bord za Standarde Finansijskog Izvestavanja

SKK 18
Ngjarjet pas datës së pasqyrës së bilancit

Qëllimi

Qëllimi i këtij standardi është që të përshkruajë:

- (a) Kur duhet t'i harmonizojë ndërmarrja pasqyrat financiare të saj për ngjarjet pas datës së pasqyrës së bilancit, dhe
- (b) Shpalosjet që ndërmarrja duhet të japë rreth datës kur raportet financiare kanë qenë të autorizuara që të nxirren dhe rreth ngjarjeve pas datës së pasqyrës së bilancit.

Standardi, po ashtu, kërkon që ndërmarrja nuk duhet të përgatis pasqyrat e saj financiare në bazë të parimit të vazhdueshmërisë, nëse rastet pas datës së pasqyrës së bilancit tregojnë se supozimi i parimit të vazhdueshmërisë nuk është i duhur.

Fushëveprimi

1. Ky standard duhet të zbatohet në kontabilitet për ngjarjet pas datës së pasqyrës së bilancit dhe për shpalosjen e tyre.

Përkufizimet

2. Shprehjet vijuese në këtë standard përdoren me këto kuptime të caktuara:

Ngjarjet pas datës së pasqyrës së bilancit janë ngjarjet: të favorshme dhe të pafavorshme, që ndodhin midis datës së pasqyrës së bilancit dhe datës kur pasqyrat financiare autorizohen që të nxirren. Dy lloje të rasteve mund të identifikohen:

- (a) ato që sigurojnë fakte për kushtet që ekzistonin më datën e pasqyrës së bilancit (harmonizimi i rasteve pas datës së pasqyrës së bilancit), dhe
 - (b) ato që duket se rrjedhin pas datës së pasqyrës së bilancit (rastet që nuk harmonizohen pas datës së pasqyrës së bilancit)
3. Procesi i përfshirë për autorizimin e pasqyrave financiare që nxirren do të ndryshojë varësisht nga struktura e menaxhmentit, kërkesat ligjore dhe procedurat e përcjella gjatë përgatitjes dhe finalizimit të pasqyrave financiare.

Shembull

Menaxhmenti i ndërmarrjes e kompletonte hartimin e raporteve financiare për vitin prej 31 dhjetor 2002 deri më 29 shkurt 2003. Më 18 mars 2003, bordi i drejtorëve i shqyrton pasqyrat financiare dhe i autorizon ato për t'u nxjerrë. Pasqyrat financiare u vihen në dispozicion aksionarëve dhe të tjerëve më 1 prill 2003. Mbledhja vjetore e aksionarëve i aprovon raportet financiare më 15 maj 2003 dhe pasqyrat financiare të aprovuara regjistrohen nga organi kompetent më 17 maj 2003.

Pasqyrat financiare autorizohen që të nxirren më 18 mars 2003 (data e autorizimit të nxirret, nga bordi i drejtorëve)

4. Në disa raste, kërkohet që menaxhmenti i ndërmarrjes t'i nxjerrë pasqyrat financiare për bordin mbikëqyrës (i përbërë kryesisht nga joekzekutues) për aprovim. Në rastet e tilla, pasqyrat financiare autorizohen të nxirren atëherë kur menaxhmenti autorizohet që t'i nxjerrë ato para bordit mbikëqyrës, nëse bordi mbikëqyrës nuk vepron si bord i drejtorëve.

Shembull

Më 18 mars 2003 menaxhmenti i ndërmarrjes lejon që pasqyrat financiare t'i dorëzohen bordit mbikëqyrës të tij. Bordi mbikëqyrës përbëhet vetëm nga joekzekutues dhe mund të përfshijë përfaqësuesit e punëtorëve dhe të interesuarit e tjerë të jashtëm. Bordi mbikëqyrës i aprovon pasqyrat financiare më 26 mars 2003. Pasqyrat financiare u vihen në dispozicion aksionarëve dhe të tjerëve më 1 prill 2003. Mbledhja vjetore e

aksionarëve pranon pasqyrat financiare më 15 maj 2003 dhe pasqyrat financiare pastaj regjistrohen me organin kompetent më 17 maj 2003. Raportet financiare lejohen të nxirren më 18 mars 2003 (data e lejimit nga menaxhmentit për t'ia dorëzuar bordit mbikqyrës)

5. Ngjarjet pas datës së pasqyrës së bilancit i përfshijnë të gjitha ngjarjet deri më datën kur raportet financiare lejohen të nxirren, madje edhe nëse ngjarjet ndodhin pas shpalljes publike të fitimit.

Njohja dhe matja

Harmonizimi i ngjarjeve pas datës së pasqyrës së bilancit

6. Ndërmarrja duhet t'i harmonizojë shumat e njohura në pasqyrat financiare të saj për t'i pasqyruar ngjarjet e harmonizuara pas datës së pasqyrës së bilancit. Pasuritë dhe obligimet harmonizohen për ngjarjet që ndodhin pas datës së pasqyrës së bilancit, kur sigurohen fakte shtesë për të ndihmuar në vlerësimin e shumave lidhur me kushtet ekzistuese në datën e pasqyrës së bilancit.
7. Shënimet harmonizuese janë subjekt i shqyrtimit të materialitetit. Informata është materiale nëse lëshimi ose mospasqyrimi i saj mund të ndikojnë në vendimet ekonomike të marra në bazë të pasqyrave financiare. Në pajtim me SKK 1 "Pasqyrimi i raporteve financiare", materialiteti varet nga madhësia dhe lloji i çështjes së gjykuar në rrethana të veçanta të lëshimit të tij, ose sa u përket çështjeve të tjera të vlerësuara së bashku.
8. Në vazhdim jepen shembujt të harmonizimit të ngjarjeve pas datës së pasqyrës së bilancit që kërkon ndërmarrja për të harmonizuar shumat e njohura në pasqyrat financiare të saj, ose për t'i njohur çështjet që nuk janë njohur më parë:
 - (a) Vendimi pas datës së pasqyrës së bilancit të një rasti gjyqësor, i cili, për arsye se e konfirmon se një ndërmarrje tanimë ka obligim të pranishëm në pasqyrën e bilancit, kërkon nga ndërmarrja që ta harmonizojë provizionin tanimë të njohur, ose ta njohë provizionin në vend të shpалosjes së saj thjesht si një detyrim të rastit;
 - (b) Pranimi i informatës pas datës së pasqyrës së bilancit që tregon se pasuria është dobësuar më datën e pasqyrës së bilancit ose që vlera e dëmit të humbur e të njohur më parë për atë pasuri, ka nevojë që të harmonizohet. Për shembull:
 - (i) falimentimi i klientit që ndodh pas datës së bilancit të gjendjes, zakonisht vërteton se humbja tashmë ekzistonte

në pasqyrën e bilancit në llogarinë e të arkëtueshmeve tregtare dhe se ndërmarrja ka nevojë për ta harmonizuar shumën e regjistruar të llogarisë së të arkëtueshmeve të tregtisë, dhe

- (ii) Shitja e stokeve pas pasqyrës së bilancit me çmim nën kosto mund të japë fakte rreth vlerës së realizueshme neto të tyre më datën e pasqyrës së bilancit
- (c) Përcaktimi i kostos së blerjes së pasurive pas datës së pasqyrës së bilancit ose të ardhurat nga shitja e pasurisë, para datës së pasqyrës së bilancit.
- (d) Zbulimi i mashtrimit ose gabimeve që tregon se raportet financiare nuk ishin të sakta.

Rastet që nuk harmonizohen pas datës së pasqyrës së bilancit

9. Ndërmarrja nuk duhet t'i harmonizojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për t'i pasqyruar rastet që nuk harmonizohen pas datës së pasqyrës së bilancit. Pasuritë dhe detyrimet nuk duhet të harmonizohen për rastet që ndodhin pas datës së pasqyrës së bilancit që nuk ndikojnë në kushtet e pasurive ose detyrimeve me datën e pasqyrës së bilancit.
10. Një shembull i rastit të paharmonizuar pas datës së pasqyrës së bilancit është zjarri që dëmton shumë fabrikën që është përdorur në prodhim midis datës së pasqyrës së bilancit dhe datës, kur pasqyrat financiare lejohen që të nxirren. Dëmi i zjarrit nuk ka të bëjë me kushtet e pasurive dhe detyrimeve më datën e pasqyrës së bilancit, por i pasqyron rrethanat që janë krijuar në periudhën vijuese. Prandaj, ndërmarrja nuk i harmonizon shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare me datën e pasqyrës së bilancit. Por, ajo mund të ketë nevojë që të japë shpalosje shtesë në pajtim me paragrafin 20.

Dividendat

11. Nëse dividendat për mbajtësit e instrumenteve të ekuitetit (siç definohet në SKK 14 "Instrumentet financiare") propozohen ose deklarohen pas datës së pasqyrës së bilancit, ndërmarrja nuk duhet t'i njohë këto dividende si obligim më datën e pasqyrës së bilancit.
12. Ndërmarrja duhet ta shpalosë shumën e dividendave që ishin propozuar ose deklaruar pas datës së pasqyrës së bilancit, por kjo para se pasqyrat financiare të jenë autorizuar që të nxirren.

Parimi i vazdueshmërisë

13. Ndërmarrja nuk duhet t'i përgatisë raportet financiare në bazë të parimit të vazhdueshmërisë, nëse menaxhmenti pas datës së pasqyrës së bilancit përcakton se ka për qëllim t'a likuideojë ndërmarrjen ose ta ndalë tregtinë apo se nuk ka alternativë tjetër reale pos të veprojë ashtu.
14. Keqësimi i rezultateve vepruese dhe i pozitës financiare pas datës së pasyrës së bilancit mund të shtrojë nevojën për të shqyrtuar nëse supozimi mbi parimin e vazhdueshmërisë është ende i duhur. Nëse supozimi mbi parimin e vazhdueshmërisë më tutje nuk është i duhur, efekti është aq i përhapshëm sa që ky standard kërkon ndryshim fundamental në bazat e kontabilitetit, më tepër se një harmonizim të shumave të njohura brenda bazës origjinale të kontabilitetit.
15. SKK 1 "Pasqyrimi i raporteve financiare" kërkon shpalosje të caktuara nëse:
 - (a) pasqyrat financiare nuk janë përgatitur në bazë të parimit të vazhdueshmërisë, ose
 - (b) menaxhmenti është i vetëdijshëm për pasiguritë materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim të madh mbi aftësinë e ndërmarrjes për të vazhduar në bazë të parimit të vazhdueshmërisë. Ngjarjet ose kushtet që kërkojnë shpalosje, mund të rrjedhin pas datës së pasqyrës së bilancit.

Shpalosja

Data e autorizimit për t'u nxjerrë

16. Ndërmarrja duhet ta shpalos datën se kur u autorizuan pasqyrat financiare për publikim dhe kush e dha atë autorizim. Nëse pronarët e ndërmarrjes ose të tjerët kanë fuqi për t'i ndryshuar pasqyrat financiare pas publikimit, ndërmarrja duhet ta shpalosë këtë fakt.
17. Është me rëndësi për përdoruesit të dinë se kur u autorizuan pasqyrat financiare për publikim, pasi që ato nuk i pasqyrojnë ngjarjet pas kësaj date.

Azhurnimi i shpalosjes rreth kushteve më datën e pasqyrës së bilancit

18. Nëse ndërmarrja merr informatën rreth kushteve që ekzistonin në pasqyrën e bilancit pas datës së pasqyrës së bilancit, ndërmarrja duhet t'i azhurnojë ato që i përkasin këtyre kushteve në dritë të informatës së re.

19. Në disa raste, ndërmarrja duhet t'i azhurnojë shpalosjet në pasqyrat e saj financiare për të pasqyruar informatën e pranuar pas datës së pasqyrës së bilancit, madje edhe kur informata nuk ndikon në shumatat që ndërmarrja i njehtë në raportet e saj financiare.
20. Një shembull i nevojës për t'i azhurnuar shpalosjet është kur evidenca vihet në dispozicion pas datës së pasqyrës së bilancit rreth një detyrimi të rastit që ekzistonte më datën e pasqyrës së bilancit. Në vazhdim duke marrë parasysh se kur duhet ta njohë tani rezervën sipas SKK 17 "Provizionet, detyrimet e kontingjente dhe pasuritë e kontingjente", ndërmarrja i azhurnon shpalosjet e saj rreth detyrimit të rastit në dritën e evidencës së tillë.

Ngjarjet që nuk harmonizohen pas datës së pasqyrës së bilancit

21. Kur ngjarjet e paharmonizuara pas datës së pasqyrës së bilancit janë të një rëndësie të tillë, që mosshpalosja e tyre të ndikojë në aftësinë e përdoruesve të pasqyrave financiare që të bëjnë vlerësime dhe vendime të duhura, ndërmarrja duhet të shpalosë informatën vijuese për secilën kategori të rëndësishme të paharmonizuar qoftë edhe pas datës së pasqyrës së bilancit:
 - (a) natyrën e ngjarjes, dhe
 - (b) një vlerësim të efektit të saj financiar ose qëndrimin se një vlerësim i këtillë nuk mund të bëhet.
22. Në vijim janë shembujt e ngjarjeve të paharmonizuara pas datës së pasqyrës së bilancit, që mund të jenë të një rëndësie të atillë që mos harmonizimi të ndikojë në aftësinë e përdoruesve të pasqyrave financiare për të bërë vlerësime dhe vendime të duhura:
 - (a) blerjet dhe heqjet nga përdorimi të mëdha të pasurive ose ekspropriimi i pasurive të mëdha nga qeveria
 - (b) shkatërrimi i impiantit të madh prodhues ose i stokeve të mëdha nga zjarri ose nga fatkeqësitë e natyrës pas datës së pasqyrës së bilancit;
 - (c) transaksionet e mëdha të aksioneve të zakonshme dhe transaksionet potenciale të aksioneve të zakonshme pas datës së pasqyrës së bilancit (SKK 19 "Fitimet për një aksion", inkurajon një ndërmarrje të shpalosë një përshkrim të transaksioneve të tilla);

- (d) ndryshimet e mëdha jonormale pas datës së pasqyrës së bilancit në normat e kursit të këmbimeve valutore;
- (e) ndryshimet në normat tatimore ose në ligjin tatimor të miratuar ose të shpallur pas datës së pasqyrës së bilancit që ka efekt të madh mbi pasuritë dhe detyrimet e tatimit kurent dhe të shtyrë (shih SKK 12 “Tatimet mbi fitim”);
- (f) hyrjet në detyrimet financiare të mëdha ose detyrimet e rastit, për shembull, duke lëshuar garancione të mëdha
- (g) fillimi i çështjeve gjyqësore të mëdha që krijohen vetëm jashtë ngjarjeve që ndodhin pas datës së pasqyrës së bilancit

Data e hyrjes në fuqi

23. Ky standard hyn në fuqi për raportet financiare duke i mbuluar periudhat prej dhe pas 1 janar 2002.